



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

OPINION MBI RAPORTIN PËR VEPRIMTARINË VJETORE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE GJATË VITIT 2021

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në përmbushje të misionit të tij, ka monitoruar të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale që nga viti 1996, e në vijim. Gjithashtu, KShH monitoroi zgjedhjet parlamentare të 25 Prill 2021, të cilat janë objekt trajtimi i Raportit për Veprimtarinë Vjetore 2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgjatë procesit parazgjedhor

KShH vlerëson pozitivisht veprimtarinë përgatitore të KQZ-së lidhur me Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të dt.25 Prill 2021, megjithë miratimin e vonuar të ndryshimeve të kryera në Kushtetutë dhe Kodin Zgjedhor (Korrik 2020). KQZ u angazhua në mënyrë intensive në përmbushjen e detyrave të reja, duke shtuar dhe ndryshimet strukturore dhe organizative, në listën e vështirësive të hasura prej tyre.

Në faqen 11 të Raportit vërehet se KQZ ka marrë 9 vendime në kuadër të hetimeve administrative të ardhura. KShH sugjeron që përkrah këtyre vendimeve duhet specifikuar e qartësuar tipologjia e tyre, p.sh. nëse këto janë denoncime të fakteve që parashikon neni 123/3 i Kodit Zgjedhor apo nëse janë denoncime të natyrës penale. Këto detaje nuk ofrohen as në Pikën 2 të Seksionin 1 të këtij Kreu, titulluar “Administrimi i denoncimeve”.

Në Seksionin 3 të Raportit “Teknologjia në Zgjedhje” trajtohet çështja e identifikimit elektronik, që u aplikua për herë të parë në këto zgjedhje. Duke patur parasysh dhe kohën e shkurtër në dispozicion, përdorimi i Pajisjeve të Identifikimit Elektronik (PEI) në 5023 Qendra Votimi, me pjesën e mbetur prej 176 QV duke vijuar nëpërmjet identifikimit manual të votuesve, konsiderohet gjerësisht një proces i suksesshëm. KShH sugjeron që shkaqet përveç mungesës së operatorëve në Ditën e Zgjedhjeve, si një prej arsyeve se pse pajisjet PEI nuk janë vendosur në përdorim, duhet të argumentohen më tej, përpos fq. 88 të Raportit¹.

Në vijim të të njëjtit Seksion, sa i përket aksesit të publikut në KQZ, KShH vlerëson se ndërkohë që transparenca në faqen zyrtare përgjithësisht ka qënë e kënaqshme dhe informacionet lehtësisht të aksesueshme, disa prej vendimeve të marra prej organeve të KQZ duhet të publikoheshin në një afat më të ngushtë në proporcion me kohën e vendimmarrjes (si p.sh. Vendimi nr. 12, datë 30.12.2020). Kjo edhe për faktin se janë vendime, të cilat kanë peshë për zhvillimin e mëtejshëm të procedurave dhe mbartin rendësi për t’u analizuar nga aktorët e tjere të interesuar, siç janë dhe organizatat jo qeveritare që monitorojnë zgjedhjet.

KShH vlerëson me rëndësi që në Seksionin 4 mbi listat e zgjedhësve duhet përmendur shkurtimisht konstatimi i publikimit në kohë të këtyre listave si dhe saktësia e tyre në proporcion me ndryshimet e mundshme të kryera përpara publikimit të listave

¹ E cila citon mungesën e aplikimeve për funksionin e operatorit në zonat e thella si arsye për 112 nga QV-të.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

përfundimtare, si dhe votimet me vendime gjyqësore. Gjithashtu KShH vlerëson shtimin në Raportin e KQZ-së, të informacionit mbi zbatimin të Nenit 52 të Kodit Zgjedhor për njoftimin me shkrim të zgjedhësve. Në vlerësimin tonë, ky është një moment i rëndësishëm në procesin parazgjedhor duke qënë se pritet të ndikojë në numrin e votuesve në Ditën e Zgjedhjeve. Për të analizuar këtë moment, vlen të përmenden edhe elemente si akordimi në kohë i fondit përkatës nga Ministria e Brendshme dhe zbatimin në kohë të detyrës për njoftim nga kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore. OSBE/ODIHR dhe KShH në raportet përkatëse të tyre mbi monitorimin e zgjedhjeve kanë cituar kryerjen e njoftimit në shtëpi si një proces të rëndësishëm të lartë².

Raporti evidenton dhe trajnimet e administratës zgjedhore duke parashtruar mangësitë në këtë proces. Duke gjykuar nga monitorimet pararendëse, KShH e njeh këtë problematikë të përsëritur, e cila nuk qëndron tek vetë kryerja e trajnimeve në datat e përcaktuara, por në ndryshimet që kryhen mbi administratën zgjedhore në nivel të dytë dhe të tretë, në momentet e fundit përpara proceseve përkatëse. Këto ndryshime ndjehen më së shumti mbi anëtarët e KQV-ve dhe GNV-ve, duke shkaktuar mungesa në disponimin e njohurive të duhura mbi ligjin dhe udhëzimet e KQZ për shkak të trajnimeve të kryera me nxitim dhe në afate tepër të ngushta, që në disa raste përkojnë me fillimin e tyre nga puna. Gjithashtu, në monitorimin e Zgjedhjeve të 25 Prillit 2021, KShH konstatoi se zbatimi i Neneve 31 dhe 38 të Kodit Zgjedhor, ku bëhet fjalë përkatësisht për emërimin e anëtarit dhe sekretarit të KZAZ-së dhe anëtarit dhe sekretarit të KQV-ve, nuk ka qënë në vëmendjen dhe, për pasojë, nuk i është nënshtruar verifikimeve të nevojshme nga KQZ (ose KZAZ). E njëjta gjë mund të thuhet dhe për Nenet 32 dhe 39 të Kodit Zgjedhor, ku bëhet fjalë përkatësisht për verifikimin nëse anëtarët e KZAZ-ve dhe KQV-ve kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë, etj. Këto elementë gjithashtu nuk janë nën fokusin e Raportit në Seksionin “Emërimi i administratës zgjedhore”, i cili përqendrohet në vlerësimin e raporteve gjinore, gjithashtu të rëndësishme dhe të parashikuara në Kodit Zgjedhor.

Tepër shkurtimisht në Raport (fq. 50), KQZ shprehet se është organizuar një tryezë e rrumbullakët: Votimi nga jashtë vendit, por për mos realizimin e parashikimeve të qarta të Neneve 24, 25 dhe 46 të Kodit Zgjedhor mbi këtë çështje, më tutje KQZ nuk shprehet më në Raport. KShH mendon se kjo çështje e rëndësishme duhet të ishte trajtuar hollësisht në Raportin e paraqitur, duke u përqëndruar në arsyet e mosrealizimit të kësaj detyre, p.sh. boshllqët në kornizën ligjore, mungesa e infrastrukturës bazë, koha e burimet e pamjaftueshme, etj.

Në Seksionin 11 “Media gjatë fushatës zgjedhore” dhe përkatësisht në çështjen e raporteve të monitorimit të medias audio dhe vizive (fq. 70), KQZ shprehet se “*Mungesa e rregullave dhe e monitorimit të medias online/sociale ka bërë që fushata e zhvilluar në to, të jetë e ashpër dhe me informacione të dyshimta me burime të pakonfirmuara. Kjo ka sjellë keqinformim dhe shpërndarje të informacioneve të rreme për publikun. Mungesa e monitorimit të medias online dhe asaj të printuar, bën të pamundur mosverifikimin e shpenzimeve të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në këto media. Gjatë kontrollit financiar të subjekteve zgjedhore për shpenzimet e fushatës, KQZ mund të konstatojë vetëm atë që vetë subjekti/kandidati ka deklaruar pa patur mundësinë për ta verifikuar/ballafaquar me të dhënat e monitorimit të këtyre mediave*”. KShH e ka

² Fq. 16 e Raportit të OSBE/ODIHR dhe fq. 8 e Raportit Përfundimtar të Monitorimit të KShH



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

evidentuar këtë problematikë në Raportin Mujor të Monitorimit të Aktivitetit të KQZ: Shkurt 2021, që në miratimin e Vendimit nr. 2 “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive” ku është shprehur se “KShH vëren se në kuadër të kushteve dhe rrethanave të pazakonta në të cilat po zhvillohet procesi zgjedhor për shkak të kufizimeve dhe ri-organizimit të formave të ndërveprimit si pasojë e pandemisë globale Covid-19, nevojitet interpretim i saktë i fushëveprimit të vëzhgimit mediatik nga ana e KQZ-së në mënyrë që të ketë vëmendje dhe ndaj përmbajtjes së mediave alternative, përfshirë platformat e mediave sociale. Media sociale, sa vjen dhe po përdoret në masë të gjerë nga përfaqësues të subjekteve zgjedhore për promovimin e veprimtarive të natyrës propagandistike zgjedhore, video, takime dhe foto me elektoratin, etj. De facto, fushata zgjedhore rezultoi se ka filluar para afatit të parashikuar në nenin 77 të Kodit Zgjedhor (një muaj para datës së zgjedhjeve). Në këtë kuptim, interpretimi i ngushtë se çfarë do të konsiderohet media dhe përjashtimi i medias sociale nga ky fushëveprim, çënon garën e ndershme dhe të barabartë si dhe integritetin e e procesit zgjedhor.” dhe “Së fundmi, platforma Facebook ka përfshirë Shqipërinë në listën e vendeve mbi të cilat aplikohen rregullat e transparencës përsa i përket reklamave zgjedhore.” që do të thotë që burimet e financimit të reklamave me këtë platformë janë tërësisht transparente për publikun apo aktorët monitorues që mund t’i aksesojnë. KShH mendon se çështja e monitorimit të mediave online dhe mediave sociale ka një ndikim të lartë negativ dhe, në këtë vështrim, sugjerimi i vetëm i paraqitur në Raport, i cili qëndron në rishikimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor, nuk e zgjidh problemin në tërësi.

KShH mendon se në Raportin e KQZ-së duhet t’i kushtohet më tepër vëmendje zbatimit të Nenit 3 të Kodit Zgjedhor “Parime të Përgjithshme” dhe në mënyrë të veçantë pikës 7 që ndalon vënien në përdorimin e subjekteve zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme pronë publike si dhe burimeve njerëzore të administratës publike të çdo niveli, e cila ka lidhje dhe me Nenin 92 të Kodit Zgjedhor që detyron institucionet publike qendrore dhe vendore të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve. KShH ka sinjalizuar disa herë pranë KQZ-së, raste të referuara prej vëzhguesve lokalë për “veprimtari të ndaluara për t’u promovuar” në kundërshtim me nenin 3, pika 1, të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator, në Bashkitë Pogradec, Dibër dhe Malësi e Madhe. Gjatë fushatës zgjedhore, një ndër problematikë e hasura ka qënë edhe përfshirja e punonjësve të autoriteteve të ndryshme të administratës publike gjatë orarit zyrtar të punës në mbledhjet apo takimet e subjekteve zgjedhore në kundërshtim me nenin 91 të KZ. Jo në të gjitha rastet, KShH është informuar nga KQZ për mbarëvajtjen e hetimit administrative të këtyre sinjalizimeve apo arsytet dhe pamundësinë objektive për hetimin e tyre konform kërkesave të Kodit Zgjedhor.

2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgjatë procesit paszgjedhor

Në faqen 88 të Raportit, KQZ shprehet mbi votat e pavlefshme dhe natyrën e pavlefshmërisë së tyre. KShH sugjeron përfshirjen në këtë raport të përqindjes së këtyre votave në total dhe nëse KQZ vlerëson se në këtë përqindje mund të ketë ndikuar edhe modeli i fletëve të votimit që u ndryshua me nxitim, e rishtazi dhe mos-sensibilizimi i nevojshëm i zgjedhësve. Gjithashtu, një nga shkaqet e përmendura për votat e pavlefshme janë dhe fletët e votimit që nuk kanë patur të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja, për të cilën KShH sugjeron përmendjen e saktë të numrit



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

të këtyre votave, sepse, pavarësisht numrit, këto raste mund të përbëjnë vepra të natyrës kriminale.

Në faqen 89 të Raportit, Seksioni 5 “Masat administrative dhe disiplinore pas verifikimit aposteriori”, citohet se “është bërë kallëzim në prokurori për 18 grupe të numërimit të votave të përbërë nga 67 vetë”. KShH sugjeron se dhe për këtë çështje duhet të ishin parashtuar më tepër detaje mbi tipologjinë e akteve që në vlerësimin e KQZ-së kanë element të veprave penale dhe ecurinë e hetimit/gjyqimit, pasi të jetë kërkuar informacioni i nevojshëm në prokuroritë dhe gjykatat kompetente.

Sa i përket Seksionit 8 “Procese të tjera”, në të cilën trajtohet dhe procesi i dekriminalizimit, jepen shifra të verifikimeve. KShH sugjeron që, duke patur parasysh natyrën e këtij Raporti, KQZ të parashtronte vështirësitë e hasura në këtë drejtim. KShH mendon se verifikimi i pastërtisë së figurës së kandidatit duhet të bëhet para se kandidaturat t’i dërgohen KQZ-së dhe për të arritur këtë sugjerohet që të kryhen ndryshimet e përshtatshme në Nenet 65 dhe 67 të Kodit Zgjedhor. Në këtë mënyrë, KQZ-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme do t’i lejohet më tepër kohë në dispozicion për verifikim të plotë dhe të gjithanshëm, element i cili do të parandalonte ndërprerjet e mandateve që mund të rezultojnë pas zgjedhjeve.